



Datë: 20.05.2026

A.nr.1838/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1838/2025, të datës 23.10.2025, të parashtruar nga ankuesi M.R dhe B. Z të cilët sipas autorizimit të përbashkët i përfaqëson ankuesi B.Z, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 20.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1838/2025 e datës 23.10.2025, e parashtruar nga ankuesi, M. R dhe B. Z.

A r s y e t i m

Ankuesi, M.R dhe B.Z (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), më datë 23.10.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër protokolli 2743/7, të datës 03.10.2025, të Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, kjo e fundit, më datë 04.11.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesit janë të punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe atë ankuesi B.Z ushtron pozitën Drejtor i Departamentit Qendror të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti, ndërsa, ankuesi M.R ushtron pozitën Udhëheqës i Divizionit të Inspektionit për Pylltari.

Tutje, sipas provave të lëndës rrjedhë së ankuesi M.R më datë 21.08.2025, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore (pranë Komisionit Disiplinor) ndaj zyrtarit-inspektorit Xh. B, për shkak të supozimit të shkeljeve të renda serioze të detyrave të punës, ndërsa, Komisioni Disiplinor i Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më Vendimin me numër protokolli 2743/7, të datës 03.10.2025, ka shpall zyrtarin Xh. B të pafajshëm.

Kundër Vendimit me numër protokolli 2743/7, të datës 03.10.2025, të Komisionit Disiplinor të MBPZHR-së ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke pretenduar së Komisioni Disiplinorë më rastin e vendimmarrjes, ka bërë aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, dhe konstatimi të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak se nuk janë shqyrtuar provat materiale të dërguar me rastin kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore. Kërkojnë që të aprovohet ankesë dhe të prishët vendimi i kontestuar.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se: “*Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative*”, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim*”, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se me vendimin e kontestuar ankuesve nuk i ka cenuar ndonjë të drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e tyre të punës, andaj, të njëjtit nuk kanë legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.1838/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa më sipër, Kolegji duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1838/2025

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të përbashkët B. Z;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MBPZHR dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.